

**Permbajtja:**

---

RAPORTI I AUDITIT TE PAVARUR	2-3
ANEKSI I PARE	4
ANEKSI I DYTE	5-7
<b>PARTIA SOCIALDEMOKRATE TE SHQIPERISE</b> Pasqyra e fondeve te perfituara dhe shpenzimeve te kryera gjate fushates zgjedhore 2015	8-9
<i>Shenime per pasqyren financiare, lidhur me fondet e perfituara dhe shpenzimet e kryera, ne fushaten zgjedhore 2015</i>	
<b>I. Te pergjithshme</b>	10
<b>II. Rregullat e vleresimit</b>	10
<b>1 Fonde te perfituara gjate fushates zgjedhore 2015</b>	11
1.1 Fondet Publike	11
1.2 Fondet jopublike (ne vlere monetare)	12
1.3 Donacionet e perfituara ne sende dhe sherbime te vleresuara me vlere tregu	12
1.4 Perfitime nga reklama televizive neni 84, pika 6 e Kodit Zgjedhor	12
1.5 Te tjera	12
<b>2. Shpenzimet e kryera</b>	12
2.1 Financimi i degeve ne rrethe per fushaten zgjedhore	12
2.3 Konsulence per fushaten (Avokatet)	13
2.4 Shpenzime telefonike	13
2.5 Shpenzime per fletevolante, fletepalosje, reklama, banderola	13
2.6 Shpenzime karburanti	14
2.7 Te tjera	14
2.8 Sherbime per sherbime te tjera	14
2.9 Kthim KQZ-se, Kthim fondesh ne baze te rezultateve	14
<b>3. Llogarite Bankare</b>	15
<b>4. Regjistrimi i fondeve jopublike te fushates</b>	15
<b>5. Ngjarje te mevoneshme</b>	16

**RAPORT I AUDITIT TE PAVARUR MBI ANGAZHIMET E  
AUDITIMIT PER QELIME TE VECANTA.**

MBI AUDITIMIN E FONDEVE TE PERFITUARA  
NE FUSHATEN PER ZGJEDHJET PER ORGANET E QEVERISJES VENDORE  
MAJ-QERSHOR 2015,  
NGA SUBJEKTI  
**PARTIA SOCIALDEMOKRATE TE SHQIPERISE**

**Drejtuar: KOMISIONIT QENDROR TE ZGJEDHJEVE**

Bulevardi "Deshmoret e Kombit"

"Pallati i Kongreseve", Tirane

Ne kemi audituar pasqyrat dhe dokumentet pasqyruese te fondeve te perfituara dhe te shpenzuara per fushaten zgjedhore, per zgjedhjen e organeve te qeverisjes vendore ne 21 Qershor 2015 te kryera nga Partia "SOCIALDEMOKRATE TE SHQIPERISE", qe perfshin periudhen 21 Maj deri me 21 Qershor 2015 si dhe te periudhave paraardhese e pasardhese ne te cilat jane kryer veprime financiare ne dobi te fushates zgjedhore .

**Pasqyrat dhe dokumentat janë përgjegjësi e drejtimit të Partise "SOCIALDEMOKRATE TE SHQIPERISE".**

Paqyrat dhe librat permbledhes te aktivitetit financiar jane pergatitur nga drejtimi i Partise "SOCIALDEMOKRATE TE SHQIPERISE" bazuar ne librin e llogarive dhe te rregjistrimit te posaçem, miratuar si model me vendim te KQZ-së, te cilët janë mbajtur për të pasqyruar të gjithë transaksionet në lidhje me fushatën zgjedhore, që kanë dhënë bazën për auditimin. Politika e ndjekur nga ana e drejtimit eshte te pergatise pasqyrat mbi bazen e fondeve te perfituara dhe shpenzimeve te realizuara gjate periudhes se fushates zgjedhore . Mbi kete baze , fondet e perfituara njihen kur fitohen ne leke ose ne material dhe sherbime te konvertuara dhe shpenzimet njihen si te tilla ne momentin qe ato jane kryer dhe jo kur ato paguhen.

**Përgjegjësia jone është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra bazuar në auditimin e kryer.**

Ne kemi kryer auditimin ne perputhje me Standartet Nderkombetare të Auditimit në referencë të vecantë me SNA 800 "Konsiderata të vecanta-Auditimet e pasqyrave financiare të përgatitura sipas kuadrove për qëllime specifike". Këto standarte kërkojnë që ne të veprojmë në pajtim me kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për faktin që pasqyra financiare e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore të mos përmbajë anomali materiale. Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencë auditimi në lidhje me shumat dhe informacionet e dhëna në pasqyra. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit dhe përfshijnë vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale të pasqyrës përkatëse, qoftë për shkak të mashtrimit, ashtu dhe të gabimit. Për vlerësimin e këtyre rreziqeve, audituesi konsideron kontrollin e brendshëm të drejtimit që ka të bëjë me përgatitjen e pasqyrës me qëllim që ai të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinionin mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të saj. Auditimi përfshin gjithashtu shqyrtimin mbi bazën e testeve, të fakteve që mbështesin shumat dhe deklarimet në aktivitetin financiar, vlerësimin e parimeve të përdorura të vlerësimeve të rëndësishme të bëra nga drejtimi.

*Ne çojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tone të auditimit.*

**Opinion**

*Sipas mendimit tone, pasqyrimi dhe perdorimi i fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore per Zgjedhjen e organeve te qeverisjes vendore ne date 21 Qershor 2015 nga Partia "SOCIALDEMOKRATE TE SHQIPERISE", jane kryer ne respekt te ligjit dhe ne perputhje me Kodin Zgjedhor.*

**Tirane me 28.09.2015**

Eksperte Kontabel e Regjistruar

**Stoli LAZE**

sh.p.k.

Stoli LAZE - Ekspert Kontabël e Regjistruar

Blv. "Gjergj Fishta", Kulla 1,

prane Gjykatës së Rrethit Tirane

Cel: 069 21 73 995 Cel1: 069 23 38 011

**RAPORT I AUDITIT TE PAVARUR MBI ANGAZHIMET**  
**E AUDITIMIT PER QELLIME TE VECANTA.**

MBI AUDITIMIN E FONDEVE TE PERFITUARA  
NE FUSHATEN PER ZGJEDHJEN E ORGANEVE TE QEVERISJES VENDORE  
MAJ-QERSHOR 2015,  
NGA SUBJEKTI  
**PARTIA SOCIALDEMOKRATE TE SHQIPERISE**

**ANEKSI I PARE**

**INFORMACIONE TE PERGJITHSHME**

**1. OBJEKTI I AUDITIMIT**

Fondet publike dhe jo publike te perfituara dhe te shpenzuara nga subjekti per fushaten zgjedhore per Zgjedhjen e organeve te qeverisjes vendore 2015.

**2. SUBJEKTI I AUDITIMIT**

Subjekti **Partia SOCIALDEMOKRATE TE SHQIPERISE**, per Zgjedhjen e organeve te qeverisjes vendore 2015.

**3. INFORMACION MBI AUDITIMIN**

- a) Auditimi eshte mbeshtetur ne dokumentacionin financiar te kesaj periudhe per periudhen (Maj-Qershor 2015).
- b) Auditimi eshte mbeshtetur ne kerkesat e LIGJIT Nr.10019, datë 29.12.2008 "KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË" i ndryshuar.

**4. PERIUDHA E AUDITIMIT**

Shtator 2015

**5. PERSONAT E KONTAKTUAR PER AUDITIMIN**

Emri Mbiemri

LIDJA KALTANJI

Pozicioni/Titulli  
SHQIPERISE"

Pergjegjes i finances Partia "SOCIALDEMOKRATE TE

## ANEKSI I DYTE

### ZBATIMI I KUADRIT LIGJOR

#### 1. **Financimi i subjekteve zgjedhore nga fondet publike**

Ne LIGJIN Nr.10 019, datë 29.12.2008 KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË i ndryshuar, Neni 87 "Shpërndarja dhe rishpërndarja e fondeve publike për subjektet zgjedhore" pika 2 shpreh " Sasia e fondeve publike që i shpërndahet secilit prej subjekteve zgjedhore caktohet me vendim të KQZ-së, sipas rregullave të mëposhtme"

#### *Konstatoj:*

Nga verifikimet e kryera rezulton se subjekti ka qene perfitues i fondeve publike per Zgjedhjen e organeve te qeverisjes vendore 2015 ne vleren 1,834,902 leke te cilat jane arketuar ne llogarine bankare te fushates.

#### 2. **Financimi i subjekteve zgjedhore nga fondet jopublike**

Ne LIGJIN Nr.10019, datë 29.12.2008 KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË i ndryshuar, Neni 89 "Financimi i subjekteve zgjedhore nga fondet jopublike" Neni 90 "Regjistrimi i fondeve jopublike" *konstatohet se:*

#### **Neni 89 pika 1 shpreh:**

Subjektet zgjedhore mund të marrin, për qëllime të fushatës së tyre zgjedhore, fonde vetëm nga persona fizikë ose juridikë vendas. Për qëllim të këtij Kodi, konsiderohet person fizik vendas edhe shtetasi shqiptar me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

#### *Konstatoj:*

Nga verifikimet e kryera rezulton se subjekti nuk ka qene perfitues i asnje fondi per qellime te fushates zgjedhore nga persona fizike apo juridike vendas kjo sipas deklarimit te perfaqesuesit si dhe te regjistrit te dhurimeve apo prej historikut te llogarise bankare.

**Neni 89 pika 2 shpreh:**

Shuma që çdo person fizik ose juridik mund t'i japë një subjekti zgjedhor nuk mund të jetë më e madhe se 1 milion lekë ose kundërvlefata në sende ose shërbime.

*Konstatohet:*

Subjekti nuk ka qene perfitues i asnje fondi per qellime te fushates zgjedhore nga persona fizike apo juridike vendas.

**Neni 89 pika 3 shpreh:**

Ndalohet dhënia e fondeve nga një person juridik apo çdo aksionar i tij nëse ndodhet në një nga kushtet e mëposhtme:

- a) ka përfituar fonde publike, kontrata publike apo koncesione në 2 vitet e fundit me vlerë mbi 10 milionë lekë;
- b) ushtron veprimtari në fushën e medias;
- c) ka qenë partner me fonde publike në projekte të ndryshme;
- ç) ka detyrime monetare ndaj Buxhetit të Shtetit ose ndaj çdo institucioni publik.

*Konstatohet:*

Nga verifikimet e kryera rezulton se subjekti nuk ka qene perfitues i asnje fondi per qellime te fushates zgjedhore nga persona fizike apo juridike vendas i cili ndodhet ne kushtet e mesiperme.

**Neni 90 pika 1 shpreh:**

Çdo subjekt zgjedhor duhet të regjistrojë në një regjistër të posaçëm, miratuar si model me vendim të KQZ-së, shumën e fondeve të përfituara për çdo person fizik ose juridik, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me identifikimin qartë të dhuruesit. Në çastin e dhurimit, dhuruesi nënshkruan një deklaratë, ku zotohet se ai nuk ndodhet në një nga rrethanat e përcaktuara në nenin 89 të këtij Kodi dhe mban përgjegjësi personale për deklaram të rremë. Forma dhe përmbajtja e deklaratës miratohet nga KQZ-ja dhe është e detyrueshme për t'u nënshkruar në



çdo rast dhurimi. Lista e personave që dhurojnë shuma jo më pak se 100 mijë lekë, si dhe vlera përkatëse duhet të bëhen kurdoherë publike.

*Konstatoj:*

Nga verifikimet e kryera rezulton se ne përputhje me kete nen, subjekti zgjedhor ka mbajtur regjister te posaçem sipas modelit te miratuar nga KQZ-ja.

**Neni 90 pika 2 shpreh:**

Dhurimi i fondeve jopublike me vlerë më të madhe se 100 mijë lekë duhet të bëhet vetëm në një llogari të posaçme të hapur në një bankë nga subjekti zgjedhor. Përgjegjësi i financës së subjektit zgjedhor, jo më vonë se tre ditë nga fillimi i fushatës zgjedhore, deklaron numrin e llogarisë bankare të hapur për këtë qëllim. Numri i llogarisë bankare për çdo subjekt politik publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

*Konstatoj:*

Nga verifikimet e kryera rezulton se subjekti eshte zoterues i nje llogarie egzistuese per dhurim fondesh per fushaten zgjedhore.

**Neni 90 pika 3 shpreh:**

Shpenzimi total që mund të kryejë një parti politike, përfshirë edhe kandidatët e tyre, për një fushatë zgjedhore nuk duhet të kalojë 10-fishin e shumës më të madhe që një subjekt zgjedhor ka marrë nga fondet publike, sipas nenit 87 të këtij Kodi. Çdo shpenzim i kryer për fushatën zgjedhore dokumentohet dhe kryhet duke respektuar legjislacionin tatimor në fuqi.

*Konstatoj:*

- Subjekti ka përfituar fonde publike dhe për rrjedhojë shpenzimet e kryera mund ti nenshtrohen krahasimit ne përputhje me piken 3 te nenit 90.
- Shpenzimet e kryera jane ne përputhje me Kodin Zgjedhor.

**Tirane me 28.09.2015**

Eksperte Kontabel e Regjistruar

**Stoli LAZE**

SH.P.R.

Stoli LAZE - Ekspert Kontabël e Regjistruar

Blv. "Gjergj Fishta" Kulla-1,

prane Gjykatës së Rrethit Tirane

Cel: 069 21 73 995 Cel1: 069 23 38 011

**PARTIA "SOCIALDEMOKRATE TE SHQIPERISE"**

Pasqyrat e fondeve te perftuara dhe shpenzimeve te kryera gjate fushates zgjedhore ne Zgjedhjet per Organet e Qeverisjes Vendore te dates 21.06.2015

**Pasqyrat e fondeve te perftuara dhe shpenzimeve te kryera  
gjate fushates zgjedhore 2015 dhe shenimet shpjeguese**

<b>PERSHKRIMI SIPAS NATYRES</b>		
<b>REF</b>	<b>NATYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE</b>	<b>VLERA</b>
<b>1</b>	<b>FONDET E PERFITUARA</b>	
<b>1.1</b>	<b>Nga fondet publike</b>	<b>1,834,902</b>
1.1.1	Fondi per Fushaten Zgjedhore 2015	1,834,902
<b>1.2</b>	<b>Donacionet e perftuara ne vlere monetare</b>	<b>0</b>
1.2.1	<i>Donacione nga persona fizike dhe juridike vendas ne llogarine e Fushates Zgjedhore</i>	<i>0</i>
1.2.2	<i>Mjete monetare te krijuara nga aktiviteti i subjektit zgjedhor</i>	<i>1,629,027</i>
1.2.2.1	Fonde te krijuara nga kartat e anetaresise, kontributet e anetareve dhe burime te ndryshme nga aktiviteti i saj.	1,629,027
1.2.2.2	Fonde te krijuara nga merreveshjet me palet e treta.	0
<b>1.3</b>	<b>Donacionet e perftuara ne sende dhe sherbime te vleresuara me vlere tregu</b>	<b>0</b>
<b>1.4</b>	<b>Perfitim e nga reklama televizive sipas ne nit 84 , pika 6.</b>	<b>0</b>
<b>1.5</b>	<b>TE TJERA</b>	<b>0</b>
1.5.1	Mjete monetare gjendje ne fillim ne Arke/Banke	0
	<b>SHUMA TOTALE E FONDEVE</b>	<b>3,463,929</b>



Pergjegjes i Finances

Lidja KALTANJI



**PARTIA "SOCIALDEMOKRATE TE SHQIPERISE"**

Pasqyrat e fondeve te perftuara dhe shpenzimeve te kryera gjate fushates zgjedhore ne Zgjedhjet per Organet e Qeverisjes Vendore te dates 21.06.2015

PERSHKRIMI SIPAS NATYRES		
REF	NATYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	
2	<b>SHPENZIMET E KRYERA PER FUSHATEN MAJ-QERSHOR 2015</b>	<b>VLERA</b>
2.1	<b>FINANCIMI I DEGEVE NE RRETHE PER FUSHATEN ZGJEDHORE</b>	<b>865,000</b>
2.1.1	Financimi i degeve ne rrethe per fushaten zgjedhore	865,000
2.2	<b>SPOTE PUBLICITARE</b>	<b>0</b>
2.3	<b>KONSULENCE PER FUSHATEN (Avokatet)</b>	<b>102,000</b>
2.4	<b>SHPENZIME TELEFONIKE</b>	<b>2,900</b>
2.4.1	Karte Telefonike	2,900
2.5	<b>FLAMUJ, BLUZA, POSTERA, FLETVOLANTE, FLETPALOSJE, REKLAME, BANDEROLA E MATERIALE TE TJERA</b>	<b>33,030</b>
2.5.1	Flamuj	10,000
2.5.2	Printime	15,000
2.5.3	Te tjera	7,630
2.6	<b>SHPENZIM KARBURANTI</b>	<b>87,500</b>
2.6.1	Karburant	87,500
2.7	<b>TE TJERA</b>	<b>120,000</b>
2.7.1	Shperblime per pune jashte orarit	120,000
2.8	<b>SHPENZIME PER SHERBIME TE TJERA</b>	<b>9,160</b>
2.8.1	Shpenzime Transporti (Taxi)	9,160
2.9	<b>Kthim KQZ-se, Kthim fondesh ne baze te rezultateve</b>	<b>826,966</b>
	<b>TOTALI I SHPENZIMEVE PER FUSHATEN</b>	<b>2,046,156</b>



Pergjegjes i Finances

Lidja KALTANJI

## ***PARTIA "SOCIALDEMOKRATE TE SHQIPERISE"***

Pasqyrat e fondeve te perftuara dhe shpenzimeve te kryera gjate fushates zgjedhore ne Zgjedhjet per Organet e Qeverisjes Vendore te dates 21.06.2015

---

### **I. Te Pergjithshme**

Partia "***SOCIALDEMOKRATE TE SHQIPERISE***" – PSDSH-ja, e krijuar me vendim gjykate Tirane, me 22.04.1991,,eshte nje organizate politike e pavarur krijuar ne konformitet te plote me Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe legjislacionin ne fuqi. PSDSH-ja eshte bashkm vullnetar i shtetasve shqiptare ne territorin e Republikes se Shqiperise, i bazuar ne idete, bindjet dhe pikepamjet ose interes e perbashketa politike, te cilet synojne te ndikojne jeten e Vendit. PSDSH eshte nje parti e qendres se majte. PSDSH mbron interes politike, ekonomike, sociale e kulturore te shtetasve te ndryshem te shqoqerise shqiptare.PSDSH kontribuon per paqen dhe qytetarine ne lufte kunder diskriminimit te te gjitha llojeve racor , fetar , kulturor, seksual etj.

Partia SOCIALDEMOKRATE TE SHQIPERISE eshte regjistruar si person juridik me iniciale PSDSH. Qellimi i saj eshte percaktuar ne akt themelimi.

Burimet financiare te Partise jane:

Te ardhurat nga kuotizacionet.

Te ardhurat nga buxheti i shtetit ne perputhje me legjislacionin per financimin e partive politike.

Ndihmat dhe dhuratat e anetareve e perkrahesve te PSDSH-se. Ndihmat dhe dhuratat e organizatave partnere.

Cdo e ardhur tjeter qe nuk bie ne kundershtrim me legjislacionin per financimin e partive politike.

- Selia e Partise eshte ne Tirane ne adresen Rr."Asim Vokshi ".Nr 26 Tirane.
- Numri i anetareve te Partise eshte mbi 3000 shtetas shqiptar me banim te perhershem ne Republikën e Shqiperise.

### **II. Rregullat e Vleresimit**

#### **Menyra e pregatitjes se Pasqyrave Finaciare**

Kontabiliteti eshte i ndertuar mbi bazen e parimeve te konstatimit. Sipas kesaj menyre fondet e perftuara ne te holla jane regjistruar ne momentin e arketimit te tyre dhe fondet e perftuara ne forme materiale dhe sherbimi ne mometin e kryerjes duke i konvertuar ne vlere leku dhe shpenzimet jane pasqyruar ne momentin e konstatimit te tyre kur jane kryer.

***PARTIA "SOCIALDEMOKRATE TE SHQIPERISE"***

**Pasqyrat e fondeve te perftuara dhe shpenzimeve te kryera gjate fushates zgjedhore ne Zgjedhjet per Organet e Qeverisjes Vendore te dates 21.06.2015**

---

**Monedha Raportuese**

Partia ka perdorur monedhen ALL si monedha baze e raportimit.

Fondet e perftuara jane marr ne leke. Shpenzimet jane kryer ne ALL.

**1. FONDET E PERFITUARA GJATE FUSHATES ZGJEDHORE 2015.**

**1.1 FONDET PUBLIKE**

1.1.1 Me daten 16/06/2015 jane kaluar ne llogari prane BKT nga Dega e Thesarit Tirane shuma 1,834,902 leke si shtese fondi per fushaten zgjedhore ne mbeshtetje te shkreses urdher shpenzim Nr 8571 i dates 10/06/2015.

**1.2 FONDET JO PUBLIKE (ne vlere monetare)**

**1.2.1 Donacione nga persona fizike dhe juridike vendas ne llogarine e Fushates Zgjedhore**

Nuk konstatohen dhurime te asnje lloji nga persona fizik apo juridik vendas.

**1.2.2 Mjete monetare te krijuara nga aktiviteti i subjektit zgjedhor**

1.2.2.1 Shuma prej 1,629,027 leke e paraqitur ne pasqyren e mesiperme perfaqeson fondet ekzistuese te krijuara me para fushates. E gjithë shuma e mesiperme eshte celje ne llogari nga data 05.06.2015

**1.3 DONACIONET E PERFITUARA NE SENDE DHE SHERBIME**

Nuk konstatohen donacione te perftuara ne sende dhe sherbime te vleresuara me vlere tregu.

**PARTIA "SOCIALDEMOKRATE TE SHQIPERISE"**

Pasqyrat e fondeve te perftuara dhe shpenzimeve te kryera gjate fushates zgjedhore ne Zgjedhjet per Organet e Qeverisjes Vendore te dates 21.06.2015

**1.4 PERFITIME NGA REKLAMA TELEVIZIVE SIPAS NENIT 84 , PIKA 6 TE KODIT ZGJEDHOR**

Nuk konstatohen shpenzime te asnje lloji persa i perket Spoteve televizive e per rrjedhoje nuk ka patur perfitime sipas Kodit Zgedhor.

**1.5 TE TJERA**

1.5.1 Ne fillim te Fushates ka patur gjendje Arke 0 leke te cilat ne pasqyren e mesiperme jane pasqyruar si fonde egzistuese.

1.5.1 Gjendja e mjeteve monetare ne daten 06.05.2015 ne Banken BKT ka qene 1,629,027 leke.

**2. SHPENZIMET E KRYERA GJATE FUSHATES ZGJEDHORE 2015**

**2.1 Financimi i degeve ne rrethe per fushaten zgjedhore**

2.1.1 Financimi i degeve te PSD PER ZGJEDHJET VENDORE TE PUSHTETIT LOKAL TE 21.06.2015

<b>Nr.</b>	<b>Dega</b>	<b>Kryetari Deges</b>	<b>Shuma lek</b>
1	Tirane	Nesti DECKA	391,000
2	Gramsh	Kalem NASUFI	30,000
3	Peqin	Besim COLLAKU	35,000
4	Has	Fiqiri MORINA	40,000
5	Kruje	Ismail STAFUKA	34,000
6	Kurbini	Zef GJETA	30,000
7	Kavaje	Bashkim TABAKU	46,000
8	Pogradec	Bedri MOKRARI	30,000



**PARTIA "SOCIALDEMOKRATE TE SHQIPERISE"**

**Pasqyrat e fondeve te perftuara dhe shpenzimeve te kryera gjate fushates zgjedhore ne Zgjedhjet per Organet e Qeverisjes Vendore te dates 21.06.2015**

9	Korce	Ermal SHIRKA	75,000
10	Kukes	Gazmend NERGUTI	34,000
11	Erseke	Paqesor CANE	60,000
12	Vlore	Delo ALIAJ	60,000
		<b>SHUMA</b>	<b>865,000</b>

**2.2 SPOTE PUBLICITARE**

Nuk konstatohet asnje reklame televizive apo asnje lloj spoti publicitar.

**2.3 KONSULENCE PER FUSHATEN (Avokatet)**

Shpenzime per perfaqesim avokatie nga Irena RESO ne shumen 102,000 leke sipas fatures tatimore shitje me Nr.28 date 08/10/2015.

**2.4 SHPENZIME TELEFONIKE**

2.4.1 Shpenzime per karta telefonike kapin vleren 2,900 leke te cilat jane konsideruar si shpenzime te fushates zgjedhore 2015.

**2.5 SHPENZIME PER FLETEVOLANTE, FLETEPALOSJE, REKLAMA,BANDEROLA**

2.5.1 Sipas fatures se thjeshte tatimore date 05/06/2015, per flamur te qepur e mjete te tjera promocionale ne vleren 10,000 leke te pergatitur per fushaten zgjedhore 2015.

2.5.2 Sipas fatures se thjeshte tatimore Nr.49 date 19/06/2015, Burbuqe Ogreni na ka faturuar per printime me ngjyra ne vleren 15,000 leke te pergatitur per fushaten zgjedhore 2015.

**PARTIA "SOCIALDEMOKRATE TE SHQIPERISE"**

**Pasqyrat e fondeve te perftuara dhe shpenzimeve te kryera gjate fushates zgjedhore ne Zgjedhjet per Organet e Qeverisjes Vendore te dates 21.06.2015**

---

2.5.3 Shpenzimet e tjerat sipas mandat pagesave ne vleren 7,630 leke per fushaten zgjedhore 2015.

**2.6 SHPENZIM KARBURANTI**

2.6.1 Sipas mandat pageses per blerje karburanti ne vleren 87,500 leke per fushaten zgjedhore 2015.

**2.7 TE TJERA**

Shperblime per pune jashte orarit ne vleren 120,000 leke gjate fushates zgjedhore 2015.

**2.8 SHPENZIME PER SHERBIME TE TJERA**

2.8.1 Shpenzime Transporti (Taxi) sipas mandate pagesave te leshuara ne shuma 9,160 leke dhe eshte konsideruar si shpenzim per fushaten 2015.

**2.9 KTHIM FONDESH NE BAZE TE REZULTATEVE**

2.9 Kthim KQZ-se, kthim fondesh ne baze te rezultateve sipas xhirimit ne banke per llogari te thesarit ne shuma 826,966 leke.

**3. LLOGARITE BANKARE DHE LEVIZJA E TYRE GJATE PERIUDHES 06/05/2015 DERI ME 16/09/2015 (per arsye te koheshtrirjes se likujdimeve) .**

Gjendja e likuiditeteve ne banke 06/05/2015 , *eshte e ndare si me poshte:*

**PARTIA "SOCIALDEMOKRATE TE SHQIPERISE"**

Pasqyrat e fondeve te perftuara dhe shpenzimeve te kryera gjate fushates zgjedhore ne Zgjedhjet per Organet e Qeverisjes Vendore te dates 21.06.2015

Nr.	Banka	Pershkrimi	Nr. i llogarise	06/05/2015
1	BKT	Llogari egzistuese ne LEKE	110000794	1,629,027.20

Partia SOCIALDEMOKRATE TE SHQIPERISE gjate fushates 2015 ka operuar ne kete llogari bankare prane BKT ne ALL.

Llogarite e celura prane bankave dhe levizja e tyre gjate periudhes 06/05/2015 - 16/09/2015

Nr.	Banka	Pershkrimi	Nr. i llogarise	06/05/2015	Hyrjet	Daljet	16/09/2015
1	BKT	Llogari egzistuese ne LEKE	110000794	1,629,027.20	1,834,902	2,527,966	935,963.20

Levizja e cash flow gjate fushates elektorale:

Pershkrimi	LEKE	EURO	TOTAL
Gjendja ne daten 06/05/2015	1,629,027.20	0,00	1,629,027.20
Hyrjet gjate fushates	1,834,902.00	0,00	1,834,902.00
Daljet gjate fushates	2,527,966.00	0,00	2,527,966.00
Gjendja ne daten 16/09/2015	935,963.20	0,00	935,963.20

#### 4. REGJISTRIMI I FONDEVE JOPUBLIKE

Fonde jopublike nuk ka patur, subjekti ishte mire informuar se si do behej regjistrimi i fondeve jopublike te perftuara gjate fushates zgjedhore 2015. Dispononin rregjistrin e posaçem, sipas modelit te miratuar me vendim te KQZ-se ku duhej te ishin pasqyruar te gjitha shumat e perftuara si dhe te dhena te tjera qe lidhen me identifikimin e qarte te dhuruesit.

Kishin dijeni per plotesimin e dhurimit, te nenshkruanin deklaratat, ku zotohen se nuk ndodhen ne nje nga rrethanat e percaktuara ne nenin 89 te ketij Kodi dhe mbajne pergjegjesi personale per deklarate te rreme. Forma dhe permbajta e deklaratave te nenshkruara eshte ajo e miratuar nga KQZ-ja. Fondi publike eshte derdhur ne llogarine e posaçme te hapur prane BKT-se me Nr llogarie 110000794, per te cilen kemi njoftuar dhe deklaruar prane KQZ-es.

**PARTIA "SOCIALDEMOKRATE TE SHQIPERISE"**

**Pasqyrat e fondeve te perftuara dhe shpenzimeve te kryera gjate fushates zgjedhore ne Zgjedhjet per Organet e Qeverisjes Vendore te dates 21.06.2015**

Shpenzimet totale qe ka kryer PSDSH-ja per fushaten zgjedhore nuk e kalojne kufirin e percaktuar ne nenin 90 te ketij ligji. Te gjitha shpenzimet e kryera gjate fushates zgjedhore jane dokumentuar duke respektuar legjislacionin tatimor ne fuqi. Ne keto pasqyra jane perfshire te gjitha fondet e perftuara dhe shpenzimet e kryera nga PSDSH-ja per fushaten zgjedhore per zgjedhjen e organeve te qeverisjes vendore 2015.

**5. NGJARJE TE MEVONESHME**

Per arsye te specifikave te vecanta te fushatave zgjedhore por edhe te politikave tregtare te paleve te treta me te cilat eshte bashkpunuar para, gjate dhe pas fushates ne pasqyrat e mesiperme eshte perfshire periudha kohore nga 06/05/2015 deri 19/09/2015. Fushata zyrtare eshte prej dates 21/05/2015 deri 20/06/2015 periudha e perfshire teper eshte pjese perberese e pasqyrave sepse eshte tregues i transaksioneve te konstatuar para apo pas fushates zyrtare po qe i perkasin perfitimeve dhe shpenzimeve per fushaten zgjedhore.



Pergjegjese e Finances

Lidja KALTANJI



OBJEKTIVI: PERGATITJA E BUXHETIT AUDIT

PARTIA SOCIALDEMOKRATE E SHQIPERISE

1.Financimi nga K.Q.Z	1,834,902 leke
2.Financimi nga Donatore	0.00 leke

Gjithsej

Ore pune te planifikuar	88 Ore
Ore pune te harxhuara	45 Ore

Indeks	PLANI I PUNES	Planifikuar	Harxhuar
	1.Takim me Drejtuesit: per kontaktim, njohje me legjislacionin ne organizimin e drejtimin, marja e misionit dhe planifikimi i tij.	6	3
	2. Organizimi i mbajtjes se llogarive te te ardhurave dhe shpenzimeve (Regjistrimi i tyre ne formularin e rekomanduar nga KQZ. Zbatimi i Standareve dhe legjislacionit tatimor. -Verifikimi i Financimit nga KQZ. -Verifikimi i Financimit nga Donoret. -Verifikimi i organizimit dhe funksionimit te kontrollit nga institucioni.	10	4
	3.Shqyrtimi dhe kontrolli i shpenzimeve sipas natyres : - Per spotet televizive -Per reklamat - Per Karburante ,etj.	8	4
	<u>a) Verifikimi i pasqyrave permbledhese per financimet.</u> -Zbatimi i rregullave, parimeve dhe metodave te perpilimit te te dhenave . Verifikimi i perputhjes se te dhenave me ato te rregjistruara ne kontabilitet dhe te formulareve tip qe ka aprovuar K.Q.Z.	10	4
	<u>Kerkesat per arketim dhe furnitoret:</u> evidentimi, kuadrimi, rakordimi, dinamika, debitoret ,arketimi dhe depozitimi i tyre si dhe detyrimet ndaj furnitoreve.	6	3
	<u>Likuiditetet dhe vlera arke te tjera</u> <u>Mjetet monetare ne banke:</u> gjendja e llogarive, perputhja me ekstraktet, dokumentimi i vlerave, evidentimi ne kontabilitet.	8	6
	<u>Mjete monetare ne arke:</u> dokumentimi i veprimeve, evidentimi ne kontabilitet, perputhja e gjendjes me librin e arkcs Verifikimi i vleresimit te veprimeve valutore te llog. bankare e arkcs:	10	4
	4.Verifikime dhe informacione specifikke	8	3
	5.Rishikimi i fleteve te punes: pergatitja e rekomandimeve dhe e sygjerimeve, shqyrtimi i tyre me Drejtimin.	10	5
	6. Pergatitja e raportit: te pergjithshem dhe raportit sqarues.	6	6
	7.Takim me Drejtuesit	6	3

PARTIA SOCIALDEMOKRATE E SHQIPERISE

Eksperte Kontabel e Regjistruar

Lidja KALTANJI

Stoli LAZE